

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2795/ Prot.

Durrës, më 2 .12 .2025

V E N D I M

Nr. 108, Datë 2 .12 .2025

P Ë R

**“ MIRATIMIN E TARIFËS SË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË RIORGANIZUAR
TË CIKLIT TË DYTË, MASTER I SHKENCAVE NË “MËSUES I SHKENCAVE
SOCIALE”, PRANË FAKULTETIT TË EDUKIMIT , NË UNIVERSITETIN
“ALEKSANDËR MOISIU” Durrës”**

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”; në VKM-në nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” i ndryshuar; në VKM-në nr.185, datë 25.3.2021, “Për ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar; VKM-në nr. 879, datë 18.12.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”; në Udhëzimin MASR Nr.1, datë 14.01.2020, “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë”, i ndryshuar; në Udhëzimin e MAS Nr.2, datë 21.01.2025, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar”; në Statutin dhe në Rregulloren e UAMD-së, vendimit të Senatit Akademik 165, datë 27.11.2025, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I :

1. Miratimin e riorganizimit mbi 20% të programit të studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në “Mësues i Shkencave Sociale”, pranë Departamentit të Psikologjisë, të Fakultetit të Edukimit, në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës, për vitin akademik 2026-2027.
2. Tarifa për këtë program studimi do të jetë 1200 lekë/kredit.
3. Programi i studimit do të zhvillohet në gjuhën **Shqipe**.